



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA V

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës

Mbledhja nr. 41

Prishtinë, më 29.11. 2016, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225

PROCESVERBAL

**I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR PUNË TË BRENDSHME, SIGURI DHE
MBIKËQYRJE TË FORCËS SË SIGURISË SË KOSOVËS**

Në mbledhje morën pjesë: Daut Haradinaj, kryetar; Ganimete Musliu, zëvendëskryetare e parë, Rexhep Selimi, Anton Quni, Qerim Bajrami, Nuredin Ibishi, Zafir Berisha, anëtarë.

Mungoi: Bojan Mitiq

Përfaqësuesit nga Ministria e Punëve të Brendshme: Valdet Hoxha, zëvendës Ministër i Ministrisë së Punëve të Brendshme, Drita Hoxha, Drejtoresha për Buxhet dhe Financa, Granit Fetahu, Departamenti i Prokurimi në Policinë e Kosovës Hamdi Hyseni-Drejtorja për buxhet dhe Financa në Policia e Kosovës

Përfaqësuesit nga Ministria e Forcës së Sigurisë së Kosovës: Haki Demolli-Ministër i FSK-së, Shkelzen Syla-Sekretar i Përgjithshëm i Ministrisë së FSK-së, Fahrije Sadikaj- Drejtoreshë e Departamentit të Financave, Kolonel-Fadil Hadërgjonaj-Këshilltar Ushtarak dhe Latif Leka-Shef i Kabinetit të Ministrit të FSK-së

Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë: Gent Gjokolli-KIPRED, Blend Zyrapi-KIPRED, Agnesa Haxhiu-KDI, Shefki Kastrati-NDI, Qëndresa Leka-NDI, Dhurata Kryeziu-OSBE.

Nga Staf i mbështetës i Komisionit: Nur Çeku dhe Zarë Aliu.

Mbledhjen e kryesoi, Daut Haradinaj, kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e komisionit e mbajtur me datë 12.10.2016;
3. Shqyrtimi i projektbuxhetit për vitin 2017 për institucionet e sigurisë;
4. Të ndryshme.

***Kryesuesi i Komisionit** konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen.*

1. Miratimi i rendit të ditës.

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e komisionit e mbajtur me datë 12.10.2016.

Procesverbali u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i projektbuxhetit për vitin 2017 për institucionet e sigurisë.

Kryetari, fillimisht theksoi që duke iu referuar raporteve për shpenzimet financiare, raporteve të Auditorit të Përgjithshëm si dhe raportimeve në media se ka pasur vonesa në pagesa , shtyrja e projekteve kapitale, kanë qenë çështje që janë diskutuar. Më tutje theksoi që çështjet që do të pyes janë si në vijim. Bartja e projekteve të pajisjet e trafikut, për armët për pajisje speciale dhe automjete speciale, pajisje për hetim të krimit, pajisje konfidenciale, tek shërbimet mbështetëse, trajnimet dhe tek policia kufitare. Fjalën ua kaloi përfaqësuesve të Ministrisë së Punëve të Brendshme.

Valdet Hoxha, zëvendës ministër i Ministrisë së Punëve të Brendshme, theksoi që vitin e kaluar Ministria e Punëve të Brendshme ka shpenzuar 98% të buxhetit por kategoritë e përmendura si të bartura kanë ardhur si rezultat i daljes së situatave të reja dhe nevojave emergjente si dhe pengesat që vijnë nga ligji i prokurimit. Më tutje theksoi që për vitin 2017, Ministria ka rritje të buxhetit për 5milion euro, duke marrë për bazë edhe situatat dhe rrjedhën e ngjarjeve.

Hamdi Hyseni-Drejtor për buxhet dhe Financa Policia e Kosovës, theksoi që sa i përket buxhetit të vitit 2015 për Policinë e Kosovës, ka pasur shpenzim 99.60%, ndërsa për vitin 2016 82% dhe është trend i mirë, duke shtuar që kanë bërë kërkesë për dy milion euro buxhet shtesë për paga dhe mëditje, janë kërkuar mjete shtesë për mallra dhe shërbime si dhe kërkesë për mbulimin e disa obligimeve të kontraktueshme. Duke u referuar buxhetit të planifikuar për vitin 2017 theksoi se nuk janë të kënaqur me ndarjen buxhetore, edhe pse ka një shtim të mjeteve në kategorinë e mallrave por nuk është e mjaftueshme me trendin aktual të shpenzimeve. Gjithashtu

theksoi që për kategorinë e mallrave janë ndarë më pak mjete në krahasim me vitet e kaluara, ndërkaq janë shtuar obligimet siç është hapja e një regjioni të ri në veri të vendit, nevoja për regjione të reja. Për vitin 2017 është paraparë vendosja e radarëve statik dhe mobil, gjithashtu janë paraparë armët për njësinë speciale, po ashtu janë paraparë disa projekte për hetime të fshehta dhe forenzikë, nevoja për automjete, projektet për ndërtim, projektet për hapjen e pikave kufitare për të cilat është arritur marrëveshje në Bruksel por që nuk janë ndarë mjete. Nga ana e Policisë së Kosovës janë parashtruar disa kërkesa shtesë të cilat nuk janë marrë parasysh. Kërkesat kanë qenë, për furnizim me uniform dhe këpucë ku janë kërkuar 4milio euro, janë kërkuar mjete financiare për dërgimin e atasheve jashtë vendit, kërkesë për municion është bërë kërkesë për blerjen e helikopterëve dhe funksionalizimin e njësisë së helikopterëve por nuk ka pasur mirëkuptim, edhe pse është themeluar Komisioni për këtë qëllim i cili ka analizuar koston financiare. Për paga janë kërkuar 1.2 milion euro shtesë, mjete shtesë për policinë rezervë, kërkesë për pagesë jashtë orarit dhe gjatë festave. Kërkesë për mjete për blerjen e pajisjeve për zbatimin e ligjit për përgjimin e telekomunikimeve. Për blerjen e helikopterëve është paraparë kostoja prej 10milion e 400mijë euro për 2017, 15 milion për 2019, 9 milion, e 740mi euro, por nuk janë ndarë mjete në këtë drejtim. Totali i kërkesave shtesë për Policinë e Kosovës për vitin 2017. 42milion 589mi euro për 2018 49milion e 440mi euro për vitin 2019, 440milion 916mi euro.

Kryetari, theksoi që duke iu referuar buxhetit për vitin 2017 shihet që ka rritje në të gjitha kategoritë, por është e rëndësishme të dihet që pse nuk janë ekzekutuar mjetet e vitit 2016 dhe kjo është identifikuar edhe në raportin e auditorit të përgjithshëm.

Rexhep Selimi, shtroi pyetjet si në vijim. Për sa mjete financiare ka ngelur Policia e Kosovës pa njësinë për Helikopter dhe kapacitet ajrore? Duke qenë se në vazhdimësi buxheti për operacione speciale dhe për departamentin e hetimeve ka shkuar në rënie, a është paraparë të rritet në këtë fushë buxheti? A është paraparë mundësia për të mbështetur Akademinë e Kosovës për Siguri Publike në infrastrukturë?

Zafir Berisha, duke e vlerësuar si të pa mjaftueshëm buxhetin e ndarë për policinë e Kosovës, shtroi pyetjet t si në vijim. Sa do të ndikoj në buxhetin e Ministrisë së unëve të Brendshme kontesti që ka ndodhur me rastin e pasaportave? A është ndërmarrë ndonjë masë për kompanitë për të cilat është raportuar dhe rekomanduar edhe nga Auditori i Përgjithshëm?

Kryetari, si është duke u menaxhuar departamenti i emergjencave, pasi në qytetin e Prishtinës është ndryshe ndërsa në komuna të tjera ndryshe? A është realizuar projekti i paraparë për riatdhesim, i cili është kusht nga BE-ja?

Ndërsa sa i përket njësisë së helikopterëve, konsideroi që ky aspekt është edhe politik për shkak të kontrollit të hapësirës ajrore.

Ganimete Musliu, shtroi pyetjen si në vijim. A janë zbatuar rekomandimet e dhëna nga Auditori i Përgjithshëm?

Anton Quni, shtroi pyetjet si në vijim. Për vërejtjet e bëra sa i përket buxhetit të ndarë, a kanë përkrahjen e Ministrisë së Punëve të Brendshme? Në cilat aspekte mund të kontribuoj Komisioni

për të plotësuar kërkesat buxhetore? Si rendite policia e Kosovës në krahasim me policinë e rajonit?

Kryetari, shtroi pyetjen. A është planifikuar që në vitin 2017 të procedohet projektligji për pensionimin e pjesëtarëve të Policisë së Kosovës?

Nuredin Ibishi, konsideroi se ka pasur mungesë të bashkëpunimit gjatë planifikimit buxhetor në mes të Ministrisë së Punëve të Brendshme, Policisë së Kosovës dhe Komisionit. Gjithashtu theksoi që vërehet që nuk ka rritje të buxhetit për sektorin e sigurisë për investimet kapitale. Më tutje theksoi që edhe në raportin e progresit janë identifikuar ngecje, të gjeturat e auditorit ët përgjithshëm tregojnë një gjendje jo të mirë në aspektin e shpenzimit të buxhetit. Po ashtu e konsideroi si ngecje mos themelimin e njësisë së helikopterëve, mos themelimin e policisë rezervë, mungesa e objekteve etj, duke theksuar nevojën për paisjen me helikopter, sa më shpejt që të jetë e mundur. Për këtë shprehi pakënaqësinë me ndarjen buxhetore për vitin 2017 dhe vitet në vijim.

Drita Hoxha- Drejtoresha për Buxhet dhe Financa, theksoi që Ministria e Punëve të Brendshme prej 53.584.135 kërkesave shtesë që ka pasur në planifiko të buxhet në dëgjimet e dyta buxhetore, kërkesat kanë rënë në 18 milion, duke iu dhënë prioritet kërkesave që kanë pasur prioritet. Më tutje theksoi që duke qenë se janë shtuar 32 zyrtar në veri të Mitrovicës, por buxheti nuk është shtuar nga Ministria e Financave dhe është dëmtuar buxheti Ministri së Punëve të Brendshme. Më tutje theksoi që projekti i pasaportave biometrik nuk është përfshirë dhe vlera e tyre është një milion e dyqind mijë euro, ndërsa sa i përket projektligjit për pensionimin e pjesëtarëve të Policës, theksoi se është biseduar për këtë çështje dhe janë gjashtë milion e pesëqind mije euro duhen, por nuk është bërë asgjë edhe për këtë vit. Ndërsa sa i përket menaxhimit të emergjencave për stafin në kuadër të zjarrfikësve, theksi që ligji për menaxhimin e financave në pushtetin lokal, nuk e lejon kalimin e buxhetit në nivelin qendror.

Valdet Hoxha, zëvendës ministër i Ministrisë së Punëve të Brendshme, në përgjigjeje të pyete së z.Zafir Berisha theksoi që sigurisht që dëmtohet buxheti me rastin e kontestit me problemet me pasaportat biometrike, që është shuma pesë milion euro. Ndërsa sa i përket pyetjes nëse do të përzgjidhen kompani të cilët kanë pasur probleme në të kaluarën, theksoi që do të zbatohen rregullat formale për të gjithë. Ndërsa sa i përket ndërtimit të objektit në Akademinë e Kosovës për Siguri Publike, theksoi që kërkesa buxhetore nuk është miratuar, pasi arsytimi ka qenë se Ligji për Veteran ka pasur shumë shpenzime dhe projektet te tjera kanë mbetur peng.

Gjithashtu theksoi që ekziston mbështetja nga Ministria e Punëve të Brendshme për kërkesat e bëra, duke shtuar se pavarësisht që kërkesat nuk janë aprovuar Policia e Kosovës do të vazhdoj të jetë në nivelin duhur

Kryetari, shtoi se do të ishte mirë që të bëhet një racionalizim më i mirë i buxhetit, pasi do të ishte mirë të shkurtoheshin disa kilometra asfaltim dhe të ndaheshin mjete për objektiva të tjerë.

Granit Fetahu, Departamenti i Prokurimit-Policia e Kosovës, theksoi që kërkesa shtesë të bëra nga Policia e Kosovës nuk kanë hasur mirëkuptim dhe buxheti i Policisë së Kosovës ka shkuar në rënie. Sa i përket njësisë së helikopterëve shtoi se sipas disa llogaritjeve të bëra për

vitin e parë nevojiten afërsisht dhjetë milionë, vitin e dytë pesëmbëdhjetë milion ndërsa vitin e tretë nëntë milion, ndërsa s ai përket automjeteve theksoi që ka vështirësi për shkak të llojeve të ndryshme të automjeteve edhe pse janë blerë disa makina të reja. Ndërsa s ai përket pagesave në fund të vitit, kjo bëhet kryesisht për pajisjet policore dhe kërkojnë procedura. Ndërsa s ai përket kompanive të cilat nuk i përmbushin projektet, nga ana e policisë bëhen padi në gjykatë, ndërsa sa i përket menaxhimit të aseteve theksoi që do të bëhen përmes sistemit PRIMIS, ndërsa sa i përket objekteve policore theksoi që vazhdimisht kërkohet të përmirësohen kushtet e punës.

Kryetari, si është çështja e projekteve të pa realizua të cilat janë bartë për vitin e ardhshëm?

Granit Fetahu, Departamenti i Prokurimit-Policia e Kosovës, në përgjigjeje të pyetjeve të z. Haradinaj theksoi që janë pajisjet specifike të policisë , të cilat shpesh shkaktojnë vonesa në realizimin e projekteve, pasi kërkon sqarime më specifike. Më tutje shtoi se për pjesën më të madhe të projekteve është nënshkruar, pro ende nuk janë porositur, për shkak se kompania nuk ka mundur të sjellë brenda vitit.

Ganimete Musliu, lidhur me blerjen e automjeteve theksoi që duket më shumë kompanitë e caktojnë llojin e automjetit sesa ligji i prokurimit.

Kryetari, theksoi që fokusimi duhet të bëhet tek shpenzimet buxhetore, duke shtuar që janë të shumta ankesat që vijnë në drejtim të anëtarëve të Komisionit dhe fakte të tilla mund të jenë me pasoja për personat përgjegjës.

Valdet Hoxha, zëvendës ministër i Ministrisë së Punëve të Brendshme, theksoi që nëse konsiderohet që ka shkelje të adresohen në prokurori.

Hamdi Hyseni-Drejtor për buxhet dhe Financa Policia e Kosovës, theksoi që planifikimet janë bërë me kohë ndërsa sa i përket Ligjit për pensionimin e pjesëtarëve të Policisë së Kosovës është kostoja prej 3.2 milion euro për vitin e parë, duke propozuar që nëse nuk realizohet për këtë vit të ketë vende të reja të punës për treqind zyrtar policor, në mënyrë që të ruhet profesionalizmi në punën e policisë.

Kryetari, theksoi nevojën për të sjell Projektligjin për pensionimin e pjesëtarëve të Policisë së Kosovës.

Hamdi Hyseni-Drejtor për buxhet dhe Financa Policia e Kosovës, theksoi që sa i përket projektligjit për pensionimin e pjesëtarëve të Policisë s Kosovës, janë bërë takime me Fondin Monetar Ndërkombëtar i cili nuk është përkrahur ashtu siç është, por mbetet të shihet si do të veprohet. Gjithashtu theksoi që do të ishte e mirëpritur që të jepet mbështetja e Komisionit që Policia e Kosovës të ketë një Kod të vetin buxhetor.

Kryetari, vlerësoi punë e bërë nga ana e Policisë s Kosovës dhe suksesin e treguar në fushën e sigurisë duke shprehur gatishmërinë për mbështetjen e punës së Policisë së Kosovës në vazhdimësi dhe falënderoi për raportimin nga ana e ministri së Forcës së Sigurisë së Kosovës.

Në vazhdimësi të takimit, ftoi për të raportuar përfaqësuesit e Ministrisë së Forcës së Sigurisë së Kosovës, duke shtuar që sa herë që është kërkuar raport me shkrim apo në Komision, gjithherë është raportuar në kohë. Më tutje shtroi pyetjen si në vijim. A janë përmbushur kapacitetet buxhetore për vitin 2017 sipas planifikimeve si Ministri e FSK-së?

Ministri i Ministrisë së Forcës së Sigurisë së Kosovës, Haki Demolli, theksoi që Forca e Sigurisë së Kosovës për vitin 2016 ka arritur suksese ndërkombëtare, siç ka qenë regjistrimi i dy kadetëve të FSK-së në Akademinë *Ēest Point*, rezultat të shkëlqyeshëm ka arritur edhe Brigada në Batalionin e reagimit të shpejtë, gjithashtu suksesi i kadetit ën Britaninë e Madhe dhe se gjatë këtij viti pjesëtarët e FSK-së kanë marrë pjesë në shkollat e NATO-s. Gjithashtu FSK ka marrë pjesë në ushtrimet e përbashkëta ushtarake bashkë me ushtritë e vendeve të rajonit dhe më gjerë, në Shqipëri, Maqedoni, Kroaci, Gjermani, Britani dhe në Shtete të Bashkuara të Amerikës. Sukses tjetër ka qenë ushtrimi ushtarak i realizuar gjatë muajit nëntor Shqiponja 5, ku pjesëmarrës skano qenë edhe ushtarët nga Ajova, KFOR-it etj. Sukses tjetër ka qenë edhe promovimi i qendrës për Kërkim Shpëtim .

Ndërsa s a i përket planifikimit të buxhetit për vitin 2017, theksoi që kjo është mbështetur në tre segmente kryesore; plani afatgjatë zhvillimor 2017-2026, plani afatmesëm 2017-2019 dhe Analiza e Rishikimit strategjik të sektorit të Sigurisë. Më tutje theksoi që plani afatgjatë është përpiluar në konsulentë të plotë me ekipin mbështetës amerikan DIR, dhe në planin afatgjatë zhvillimor të FSK dhe është paraparë kostoja buxhetor për krijimin e kapaciteteve të plota operacionale për Forca të Armatosura për periudhën dhjetëvjeçare dhe është ndarë në tre faza. Ndërsa s i përket buxhetit të paraparë për transformimin e FSK-së në Forca të Armatosura tetëqind e njëmbëdhjetë milion euro, ndërsa s ai përket buxhetit të vitit 2017 theksoi që për Ministrinë e FSK-së, është planifikuar buxheti prej pesëdhjetë e një milion euro, i ndarë në kategori. Ndërsa sa i përket projekteve kapitale të cilat e kalojnë vlerën mbi një milion për vitin 2017 janë paraparë katër projekte të tilla, dhe janë projekte për automjete taktike, autobllinda, armatim të lehtë dhe projekt për menaxhimin e informatave. Në kabinetin e Ministrit do të ketë një zvogëlim të buxhetit dhe administrata qendrore ndërsa rrije do të ketë në buxhetin Forcës së Sigurisë së Kosovës.

Kryetari, duke iu referuar analizës së përgatitur nga NDI, duket se Qeveria ka tërhequr mjete të cilat ishin ndarë më herët.

Ministri i Ministrisë së Forcës së Sigurisë së Kosovës, Haki Demolli, theksoi që buxheti i cili ndahet për blerjen e pasjeve, blerja e tyre nuk mund të bëhet pa ndryshimin mandatit të FSK-së në Forca të Armatosura.

Zafir Berisha, shtroi pyetjet si në vijim: A ka pasur nga Ministria FSK-së ka pasur kërkesa buxhetore e cila nuk ka pasur mbështetje nga Ministria e Financave, kërkesë e cila do të pengonte zhvillimin e FSK-së në Forca të Armatosura? Duke iu referuar fjalës së Ministrit, që shuma prej tetëqind milion euro do të jetë e nevojshme, për sa kohë është e planifikuar kjo shumë? Duke konsideruar që çështja e transformimit të FSK-së do të duhej të shtyhet përpara në mënyrë që mos të mbeten vetëm në letër planifikimet për procesin e transformimit.

Nuredin Ibishi, shtroi pyetjet si në vijim; A është shqyrtuar mundësia që çështjet që kanë të bëjnë me planifikimet buxhetore të shqyrtohen në Komisionin paraprakisht dhe jo në fazën e shqyrtimit të projektligjit të buxhetit? A ka ndonjë kërkesë të veçantë buxhetore që Komisioni mund të mbështeste?

Ganimete Musliu, shtroi pyetjet si në vijim; Propozimet për kërkesa buxhetore të cilat i janë dërguar Ministrisë së Financave, a janë ndryshuar dhe nëse po cilat janë ndryshuar?

Anton Quni, shtroi pyetjen si në vijim; A ka ndonjë vlerësim në raport me ushtritë e rajonit dhe ku radhitet FSK-ja sa i përket buxhetit?

Ministri i Ministrisë së Forcës së Sigurisë së Kosovës, Haki Demolli, në përgjigjeje të pyetjeve të znj. Musliu, duke vlerësuar kontributin e z. Daut Haradinaj për bisedimet me Ministrinë e Financave theksoi që kërkesa e Ministrisë së FSK-së për vitin 2017 ka qenë që të aprovohet një buxhet prej pesëdhjetë e katër milion euro, që do të thotë tre milion euro më shumë, por kjo shumë nuk është aprovuar duke u kërkuar mirëkuptimi që pasi ende nuk është marrë vendimi politik për transformimin e FSK-së në Forca të Armatosura me kusht që në vitin 2018 dhe 2019 të ofrohet një rritje më e madhe e buxhetit. Për këtë arsye është vendosur që disa kërkesa që mund të shtyhen për më vonë të mirëkuptohet vlerësimi i Ministrisë së Financave. Ndërsa në përgjigjeje të pyetjes së z. Berisha, theksoi që analiza e procesit të transformimit të FSK-së në Forca të Armatosura është bërë në koordinim të plotë me ekipin amerikan në DIR që për periudhën dhjetë vjeçare do të arrihen kapacitete e plota operationale, por nëse ndërkohë ofrohen mjete financiare afati prej dhjetë vjetësh mund të shkurtohet. Ndërsa sa i përket personelit që do të rekrutohet, theksoi që fokusimi është në rekrutimin e pjesëtarëve të FSK-së ndërsa i përket rritja e numrit të administratës theksoi që rritja do të jetë vetëm në aspektin e uniformës dhe rekrutëve të rinj.

Ndërsa sa i përket analizimit dhe krahasimit të FSK-së me ushtritë e tjera, theksoi që FSK-ja ka më pak buxhet, nëse e krahasohet me vendet e rajonit dhe më gjerë por në të ardhme kjo do të ndryshoj.

Shkelzen Syla, Sekretar i përgjithshëm i Ministrisë së FSK-së, theksoi që janë realizuar disa takime me zëvendësministrin e Ministrisë së Financave dhe është kërkuar mirëkuptimi nga ana e Ministrisë së FSK-së që për vitin 2017 të mos realizohet kërkesë prej pesëdhjetë e katër milion, me kushtin që të gjitha kërkesat e bëra për vitin 2017 të barten për vitin 2018 dhe 2019. Vlera e paraparë për ndërmarrjen e veprimeve nga ana e FSK-së deri në arritjen e kapaciteteve operationale është vlerë e kalkuluar nga grupet punuese.

Kryetari, shtroi pyetjen si në vijim. Sipas analizës së bërë për buxhetin e Ministrisë së FSK-së, duket që ka rritje prej 26% në mallra dhe shërbime, si shpjegohet kjo?

Shkelzen Syla, Sekretar i përgjithshëm i Ministrisë së FSK-së, theksoi që në kuadër të mallrave dhe shërbimeve janë edhe pajisjet individuale, veshmbathjet, uniformat, çizmet dhe pasi planifikohet rritja e personelit duhet të bëhet përgatitja e pajisjeve individuale.

Ministri i Ministrisë së Forcës së Sigurisë së Kosovës, Haki Demolli, theksoi që në mallra dhe shërbime janë të përfshira edhe trajnimet jashtë vendit, shërbimet e telekomunikimit, shkollimi në NATO, blerje të ndryshme, ushqimi dhe lëndët djegëse.

Kryetari, kërkoi një sqarim sa i përket shpenzimeve kapitale, ku për vitin 2017 ka një rritje në krahasim me vitet paraprake?

Shkelzen Syla, Sekretar i përgjithshëm i Ministrisë së FSK-së, theksoi që sipas politikave qeveritare dhe të Fondit Monetar Ndërkombëtar lejohet rritja e mjeteve për investimet kapitale pasi këto krijojnë vend të reja të punës, dhe kërkohet ulja e shpenzimeve në mallra dhe shërbime dhe në shpenzime komunale, duke shtuar që kjo ka qenë e mirëseardhur për FSK-në. Ndërsa s ai përket vërejtjes në raportin e Auditorit të Përgjithshëm, që buxheti shpenzohet në fund të vitit theksoi që arsyeja është e ditur, pasi për pajisjet specifike për të cilat nënshkruhen kontratat në fillim të vitit mes Ministrisë dhe përfaqësuesve të prodhuesve, është pasi në shtetin ku prodhohen mjetet kërkohet afati kohor që të jepet leje e eksportit që është katër deri në gjashtë muaj.

Ministri i Ministrisë së Forcës së Sigurisë së Kosovës, Haki Demolli, theksoi që të gjitha rekomandimet e Auditorit të Përgjithshëm janë analizuar dhe janë ndërmarr masat për të shmangur zgjatjen e procedurave.

Kryetari, kërkoi që në raportimet vjetore të pasqyrohen edhe donacionet të cilat jepen për Ministrinë e FSK-së.

Zafir Berisha, shtroi çështjen e titullarit të pronave në të cilën e është e vendosur FSK-ja, si qëndron kjo çështje?

Shkelzen Syla, Sekretar i përgjithshëm i Ministrisë së FSK-së,sa i përket raportimeve të donacioneve theksoi që në pasqyrat financiare për çdo vit paraqiten të gjitha donacionet që merr Ministria e FSK-së. Ndërsa s ai përket raporteve të Auditorit të Përgjithshëm theksoi se që nga viti 2009 raportit dalin me opinion të pa modifikuar. Ndërsa sa i përket çështjes së pronave ku është e vendosur FSK-ja theksoi që në të gjitha pronat ku është e vendosur FSK-ja kanë qenë prona të ish ushtrisë jugosllave dhe në disa prej tyre janë të vendosura FSK-ja,ndërsa disa të tjera që nuk kanë qenë të nevojshme i janë dorëzuar Ministrisë së Administratës Publike, ndërsa objekti në Istog është marrëveshja për shfrytëzim në afat të pacaktuar me komunën e Istogut. Më tutje theksoi që në nivel të Qeverisë është ngritur një Komision ndërministror i cili është duke punuar për finalizimin e procesit për të gjitha pronat që kanë qenë të vendosura ish ushtria Jugosllave.

Nuredin Ibishi, duke iu referuar kontratave mbi një milion euro, kërkoi që gjatë vitit 2017 do të ishte mirë që për shumën të tilla të raportohet sa herë që është e nevojshme. Më tej shtroi pyetjen; A konsideroni që sa më shpejt duhet procedohet Projektligji për transformimin FSK-së në Forca të Armatosura.

Ministri i Ministrisë së Forcës së Sigurisë së Kosovës, Haki Demolli, theksoi që draft ligji për transformimin e FSK-së në Forca të Armatosura janë proceduar në Qeveri gjithashtu janë

proceduar edhe amendamente kushtetuese, por tashmë dihet në opinion që problemi është tek votimi nga ana e Listës Serbe.

Kryetari, shtroi çështjen e ushtruesve të detyrës dhe gradimeve, duke kërkuar që ky proces të përfundo sa më shpejt.

Shkelzen Syla, Sekretar i përgjithshëm i Ministrisë së FSK-së, sa i përket kontratave mbi një milion euro, konsideroi që përderisa projektligji për buxhet miratohet nga Kuvendi kjo konsiderohet e konsumuar, në raste se do të ketë ndryshime të këtij buxheti do të duhej të njoftohej komisioni.

Ministri i Ministrisë së Forcës së Sigurisë së Kosovës, Haki Demolli, falënderoi për gatishmërinë që ka Komisioni për të mbështetur Ministrinë e FSK-së dhe Ministria do të jetë transparente sa herë që do të kërkohej.

Kryetari, theksoi që Komisioni është i gatshëm për të mbështetur punën e FSK-së dhe falënderoi për raportimin në Komision.

4. Të ndryshme.

Kryetari, njoftoi anëtarët e Komisionit për tryezën rajonale për Rolin e Parlamenteve në Mbikëqyrjen e Masave të Implementuara në Parandalimin dhe Luftimin e Ekstremizmit të Dhunshëm e organizuar nga Qendra e Gjenevës për Kontroll Demokratik(DCAF) e cila do të mbahet me datë 30 nëntor 2016 në Prishtinë dhe ftoi për kontributin e anëtarëve të Komisionit.

Kryetari, me këtë pikë të rendit të ditës, e konsideroi mbledhjen e mbyllur.

Mbledhja përfundoi në orën 13:10.

E përgatiti:
Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetari i Komisionit,

Daut Haradinaj